

ETIKA E MEDIEVE DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË MEDIE

Udhëzimet dhe kodi i sjelljes

*Save the Children dhe Universiteti i Prishtinës
"Hasan Prishtina," Fakulteti i Filologjisë,
Departamenti i Gazetarisë*

HYRJE

Ky është një dokument i përditësuar, i mbështetur në një varg kursesh trajnuese dhe punëtorish për portretizimin e fëmijëve në medie në Kosovë. Sesionet janë mbajtur nga ana e gazetarit dhe këshilltarit për medie, David Hayward për Save the Children dhe Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Filologjisë, Departamentin e Gazetarisë.

Versioni i fundit i këtij dokumenti është shkruar me mbështetjen e Save the Children dhe Departamentit të Gazetarisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Ky kod i sjelljes është i bazuar në diskutimet me gazetarë, përfaqësues nga Komisioni i Pavarur për Media i Kosovës, organizata monitoruese, profesionistë të OJQ-ve për medie, studentë të gazetarisë dhe profesorë universitarë, si nga universitetet private edhe ato publike.

Qëllimi i kodit të sjelljes është krijimi i një udhëzuesi të qasshëm (në internet dhe si broshurë) për përfshirjen në mënyrë të përgjegjshme të fëmijëve në medie. Kodi mbështetet në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF), kodin e sjelljes së Komisionit të Pavarur për Media të Kosovës, dhe udhëzimet editoriale të BBC-së.

RAPORTIMI NË MËNYRË TË PËRGJEGJSHME I FËMIJËVE NË MEDIE

Është detyrë e medieve dhe gazetarëve në Kosovë që të kryejnë raportim të përgjegjshëm të fëmijëve dhe të rinjve

të ekspozuar ndaj rreziqeve, në rastin e përfshirjes së tyre në lajme. Kjo nënkupton përgjegjësinë e medies në zbatimin e Kodit të etikës dhe monitorimin e medieve në baza ditore.

PORTRETIZIMI I FËMIJËVE NË MEDIE

Neni I i KDF-së përcakton: Me fjalën fëmijë nënkuptohet çdo njeri nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

Shpeshherë përshkrimi i fëmijëve në medie mund të jetë keq-informues. Mjaft shpesh, fëmijët shfaqen në stereotipa negative, të tilla si:

- Viktima
- Fëmijë të varfër/uritur
- Fëmijë problematik
- Adoleshentë të papërgjegjshëm
- Fëmijë djallëzor'/trazovaç

Fëmijët duhet të portretizohen në mënyrë që të mos iu cenohen të drejtat; ata do të duhet të shihen si individë.

RAPORTIMI I FËMIJËVE TË GRUPEVE ETNIKE MINORITARE DHE KOMUNITETEVE

Fëmijët nuk duhet të portretizohen negativisht për shkak të racës së tyre, fesë apo komunitetit. Ata nuk duhet të përballen me diskriminim në medie apo të

trajtohen ndryshe për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Duhet pasur kujdes që të mos viktimizohen grupet minoritare, si romë, ashkali dhe egjiptianë. Kur raportohet për grupe të pakicave etnike, nuk duhet të përdoren fëmijët që mund të identifikohen lehtësisht për të përshkruar komunitetin në tërësi.

Imazhet e fëmijëve dhe të rinjve të parregulluar mund të çojnë në përforcim të paragjykimëve të dëmshme. Përkundrazi, fëmijët me prejardhje nga pakicat etnike duhet përkrahur për atë që ata mund të bëjnë. Për shembull, në arritjen e standardeve të larta në shkollë, arsim ose në fushat sportive dhe artistike.

Ashtu si të gjithë fëmijët, ata duhet të trajtohen si individë dhe njerëz me të drejtat e tyre.

RAPORTIMI PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të trajtohen me respekt dhe të mos u cenohen të drejtat e tyre të njeriut. Konsideratë e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit të gjuhës dhe mënyrës se si fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara portretizohen në medie.

Të gjithë fëmijët kanë të njëjtat të drejta të njeriut, për shembull, fëmijët nuk duhet të përshkruhen si të sëmurë mendorë. Termet e sakta janë: ata kanë vështirësi në mësimnxënie apo probleme të shëndetit mendor. Fëmijët që përdorin karroca nuk janë të lidhur për karroca, por ata janë

përdorues të karrocave. Gjatë raportimit, gjëja më e rëndësishme që duhet të merret parasysh është “A jam duke e trajtuar këtë fëmijë me dinjitet çfarë ai/ajo meriton?”

RAPORTIMIN PËR FËMIJËT NË VARFËRI

Fëmijët nuk duhet të portretizohen si viktimë të varfërisë. Ata duhet të jenë të mbrojtur nga diskriminimi dhe lëndimi në të ardhmen. Mediet nuk duhet t'i përdorin ata për të ilustruar stereotipat e të varfërve dhe të rrezikuarve. Për shembull, është shumë e lehtë të përdoren fëmijët e uritur si imazhi më i fuqishëm për të përshkruar urinë. Megjithatë, kjo i dehumanizon ata. Nëse gazetarët do t'i përdorin këto pamje, atëherë duhet të ekzistojë konteksti. Kur është e përshtatshme, ata duhet të trajtohen si individë, e jo si një objekt për të arritur ndikim emocional.

Një shembull i mirë për këtë është dokumentari i BBC-së, Vija e Frontit të Ebolës, që ka të bëjë me trajtimin e fëmijëve me ebolë në Afrikën Perëndimore. Fëmijët në film trajtohen me ndjeshmëri dhe dinjitet. Ata janë një pjesë qendrore e rrëfimit dhe pozita e tyre është vënë në një kontekst global.

<http://www.bbc.co.uk/programmes/b04plw27>

Në anën tjetër, ka mjaft raste ku të drejtat e fëmijëve nuk respektohen dhe ata portretizohen negativisht. Të tilla janë shembujt e dhënë më poshtë:

<https://www.youtube.com/watch?v=FikEo54vj-o>

FËMIJËT NË FUSHATA ZGJEDHORE

Fëmijët nuk duhet të shfrytëzohen gjatë fushatave zgjedhore politike. Ata duhet të trajtohen me respekt dhe t'u lejohej të ruajnë të drejtën e tyre për privatësi. Ka një traditë të gjatë të politikanëve që përdorin fëmijët për të përmirësuar imazhin e tyre gjatë fushatave zgjedhore. Fotot e politikanëve që mbajnë foshnja shpesh janë tërheqëse. Megjithatë, rastet kur fëmijët përdoren për të tërhequr publicitet dhe për të fituar më shumë vota (duke i nxjerrë fëmijët nga shkolla, përdorimi i tyre për marifete publiciteti, etj.), ose kur përdoren si një mjet negativ për të sulmuar kundërshtarët, duhet të censurohen.

Shembulli i “Veshit të Xheniferit”, gjatë zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 1992 në Britani të Madhe, është një ilustrim shumë i mirë se si të drejtat e fëmijës mund të dëmtohen seriozisht nga lufta e brendshme politike.

http://en.wikipedia.org/wiki/War_of_Jennifer%27s_Ear

Në përgjithësi, është roli i gazetarëve që t'i mbrojnë fëmijët gjatë fushatave zgjedhore duke iu përmbajtur kodit të sjelljes, duke respektuar të drejtat e fëmijëve sipas konventës, dhe duke ngritur zërin kundër keqpërdorimeve dhe duke vënë në dukje parregullsitë.

MBROJTJA E FËMIJËVE DHE E DREJTA PËR PRIVATËSI

Fëmijët kanë të drejtë në mbrojtje dhe privatësi. Kur fëmijët përfshihen në lajme,

gazetarët dhe mediet duhet të kenë lejen dhe pëlqimin e prindërve apo kujdestarëve të tyre. Prindërit dhe kujdestarët duhet të jenë të informuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë mbi rrezikun dhe pasojat për fëmijën para se të pajtohen të japin lejen. Kjo është e njohur si pëlqim i informuar.

Për më shumë informata, klikoni në linkun e më poshtëm për të parë forma të ndryshme të pëlqimit dhe udhëzimeve:

http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/page/guidance-consent-how#Use_of_Standard_Contributor_Consent_Form

Fëmijët nuk duhet t'u nënshtrohen ekspozimeve të natyrës negative në medie. Kjo përfshin ekspozimin në medie dhe video të cilat tashmë ekzistojnë në mediet sociale. Është detyrë e të gjitha agjencive/organizatave që të sigurojnë të drejtën e fëmijëve për privatësi, në mënyrë që të mos dëmtohen fëmijët si rezultat i ekspozimit të tyre në medie.

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA PËRMBAJTJA E DËMSHME

Fëmijët nuk duhet të ekspozohen ndaj përmbajtjes së dëmshme që shfaqet në ekran. Ata duhet të mbrohen nga pamje të cilat mund të kenë ndikim afatgjatë dhe të dëmshëm tek fëmijët. Këtu bëjnë pjesë imazhet e dhunshme apo të natyrës seksuale, pornografia eksplicite dhe gjuha e papërshtatshme. Duhet të ndërmerren masa për paralajmërimin e fëmijëve dhe të rriturve lidhur me përmbajtjet e dëmshme dhe për atë që ajo të shfaqet në kohë të përshtatshme.

Programet e lajmeve dhe të çështjeve aktuale duhet të paralajmërojnë shikuesit rreth raporteve të lajmeve që përmbajnë pamje të dhunshme apo shqetësuese, të cilat mund të kenë ndikim negativ në mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve. Kujdes i veçantë duhet kushtuar rasteve të raportimit për krime të dhunshme, zona të luftës, rajone të katastrofave, vdekje, dhunime, vrasje e sëmundje. Mbulimi global i krizave si ai i ebolës, kanë paraqitur disa pamje shumë shqetësuese dhe të fuqishme. Është e rëndësishme që këto fotografi të përdoren me kujdes dhe që të jepet paralajmërimi i duhur.

Paralajmërimet duhen të shfaqen para raporteve të lajmeve dhe programeve të çështjeve aktuale në të cilat shfaqen fotografi flakëruese (flash photography). Fotografitë flakëruese mund t'u shkaktojnë probleme serioze personave me gjendje të caktuara shëndetësore. Paralajmërimi duhet të formulohet si më poshtë:

“Programi në vijim përmban fotografi flakëruese dhe pamje flakëruese.”

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA PËRMBAJTJET E DËMSHME NË MEDIET DIGJITALE DHE SOCIALE

Duhet kushtuar kujdes mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve nga përmbajtjet e dëmshme në mediet digjitale dhe sociale. Platformat duhen të ndërmarrin masa për të raportuar dhe për të larguar materialet fyese, që mund të ketë ndikim negativ në jetën e fëmijëve dhe të rinjve. Prindërit duhet të edukohen nga

mediet që të marrin përgjegjësi për fëmijët e tyre dhe për llogaritë e tyre në mediet sociale. Prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve duhet të kuptojnë ndikimin që mund të kenë veprimet e tyre në jetën e fëmijëve të tyre.

Neni 17 i KDF-së (Qasja në informata; mjetet e komunikimit masiv)

Fëmijët kanë të drejtë për informata, të cilat kanë rëndësi për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Qeveritë duhet t'i inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv - radion, televizionin, gazetatat dhe burimet në internet - që të ofrojnë informata të cilat fëmijët mund t'i kuptojnë dhe jo të promovojnë materiale të cilat mund t'i dëmtojnë fëmijët. Mjetet e komunikimit masiv duhet të inkurajohen veçanërisht që të ofrojnë informata në gjuhët të cilat fëmijët e pakicave dhe të autoktonëve mund t'i kuptojnë. Fëmijët po ashtu duhet të kenë qasje në libra për fëmijë.

SEKUALIZIMI I FËMIJËVE

Fëmijët nuk duhet t'i ekspozohen seksualizimit. Kodi i veshjes së prezantuesve, gjatë punës me fëmijë, duhet të jetë i përshtatshëm dhe fëmijët nuk duhet t'i ekspozojnë ndaj veshjeve tepër seksuale. Fëmijët duhet të mbrohen nga shikimi i materialeve eksplicite, qoftë ajo në video muzikore, programe televizive apo filma.

Fëmijët nuk duhet të portretizohen si objekte seksuale. Kujdes të veçantë duhet kushtuar kodit të tyre të veshjes dhe imitimit të sjelljes seksuale në medie.

Fëmijët nuk duhet të shfrytëzohen si dekor. Prania e tyre në një program duhet të jetë kuptimplotë. Ata duhet të jenë kontribues në përmbajtje.

ZËRI I FËMIJËVE DUHET DËGJUAR

Fëmijët kanë të drejtë për t'u dëgjuar. E drejta e tyre për pjesëmarrje në medie është një e drejtë me rëndësi qendrore në KDF.

Në lajme, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me ligjin, ata do të duhet të lejohen të shprehin mendimet dhe pikëpamjet personale.

“Koha dhe përvoja tregojnë se fëmijët - madje edhe fëmijët shumë të vegjël - kur u jepet kohë dhe mundësi, tregojnë se jo vetëm që kanë pikëpamje, përvoja dhe perspektiva për të shprehur, por që shprehja e tyre mund të kontribuojë pozitivisht në vendimet që ndikojnë në realizimin e të drejtave dhe mirëqenies së tyre.” “Është e drejtë e çdo fëmiju që të dëgjohet”, UNICEF - udhëzuesi burimor i komitetit të OKB-së për të drejtat e Fëmijës, komenti i përgjithshëm nr. 12.

Neni 13 i KDF-së (Liria e shprehjes):

Fëmijët kanë të drejtë të marrin e të këmbëjnë informata, për aq sa informatat e tyre nuk janë në dëm të tyre apo të të tjerëve. Në ushtrimin e të drejtës për lirinë e shprehjes, fëmijët kanë përgjegjësi për të respektuar të drejtat, liritë dhe reputacionin e të tjerëve. Liria e shprehjes përfshinë të drejtën për të këmbyer informata në çfarëdo mënyre që ata zgjedhin, duke përfshirë të folurit, vizatimin ose me shkrim.

QASJA NË MEDIE, PËRFSHIRË EDHE MEDIEN DIGJITALE E SOCIALE

Fëmijëve duhet t'u lejohet qasja në medie, duke përfshirë mediet sociale dhe digjitale. Marrëdhënia e fëmijëve me mediet përbën një portë hyrëse në botën e fëmijëve dhe të drejtat e tyre për arsimim, liri të shprehjes, identitet, shëndet, dinjitet dhe mbrojtje. Masmédia ka një funksion të rëndësishëm për të siguruar që fëmijët gëzojnë qasje në informata dhe materiale të cilat kanë për qëllim të nxisin mirëqenien e tyre shoqërore, shpirtërore dhe morale. Po ashtu duhet t'i kushtohet rëndësi ekspozimit të mediave në internet. Portalet e lajmeve duhet të tregojnë kujdes dhe përgjegjësi për të moderuar komentet e publikut, në mënyrë që të ruajnë standarde të larta.

EDUKIMI I SHOQËRISË PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Mediet luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës. Ato kanë për detyrë të informojnë dhe edukojnë shoqërinë e gjerë në lidhje me temat të cilat i prekin fëmijët.

Prindërit dhe publiku i gjerë duhen të informohen lidhur me ndikimin e veprimeve të tyre tek fëmijët. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fushën e medieve sociale dhe digjitale. Prindërit dhe kujdestarët duhet të kuptojnë efektin që fotografitë dhe pamjet e fëmijëve mund të kenë në zhvillimin e tyre të ardhshëm dhe në të drejtën e privatësisë.

Komisioni i Pavarur i Mediave i Kosovës dhe Organi për Komunikata për Shtyp ofrojnë mbështetje, udhëzime dhe mund t'i adresojnë ankesat lidhur me mbulimin e fëmijëve në medie.

Publiku i gjerë duhet të informohet lidhur me masat që duhet ndërmarrë për të mbrojtur fëmijët nga përmbajtja e papërshtatshme në mediet digjitale dhe sociale. Ata duhet të sigurohen se fëmijët kanë qasje vetëm në ueb faqet dhe rrjetet/platformat e medieve sociale dhe TV-të e përshtatshme për moshën e tyre.

Stacionet televizive po ashtu duhet të sigurohen që një material i cili konsiderohet i papërshtatshëm për transmetim para kohës së kufizimit nuk transmetohet të nesërmen para kohës së kufizimit.

“Koha e kufizimit e orës 21:00 sinjalizon fillimin e kalimit në materiale për më të rritur, por ndryshimi nuk duhet të jetë i menjëhershëm. Krijuesit e programit dhe të orarit duhet gjithashtu të kenë parasysh natyrën e kanalit dhe pritjet e shikuesve. Materialet më të forta duhet të paraqiten më vonë në orar.”

<http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/page/guidelines-harm-watershed>

INTERVISTIMI I FËMIJËVE

Duhet pasur kujdes të veçantë kur intervistohen fëmijët në medie. Ata nuk duhet intervistuar në befasi dhe nuk duhet pritur në pragun e derës për t'i marrë në intervistë. Fëmijët duhet të jenë të informuar dhe të

përgatitur plotësisht, para se të marrin pjesë në një intervistë dhe t'u tregohet saktësisht se si do të përdoret intervista dhe pamja e tyre. Për intervistimin e fëmijëve gjithmonë duhet të kërkohet leja nga prindërit ose kujdestarët e tyre.

Gazetari duhet të bëjë gjithçka në mundësitë e tij që t'i qetësojë fëmijët para çfarëdo interviste apo xhirimi. Kaloni kohë duke biseduar me ta paraprakisht, shpjegojuni se çfarë po bëni dhe pse. E gjithë kjo do të sigurojë intervistë shumë më të mirë.

Gjithmonë kuptojeni se fëmijët në çdo kohë kanë të drejtë të mos përgjigjen në pyetje ose të mos intervistohen, madje edhe nëse prindërit e tyre kanë dhënë pëlqimin me shkrim.

Ka shumë shembuj kur të drejtat e fëmijëve dëmtohen rëndë nga gazetarët dhe mediet në përgjithësi, duke i ndjekur ata për të marrë një intervistë. Në tetor të vitit 2013, vëmendje e madhe i është kushtuar një vaje të re bjonde, me emrin Maria, e cila jetonte me një familje rome në Greqi. Kjo histori ilustron presionin dhe paragjykimet që mund të jenë shumë të rënda për fëmijën në qendër të saj.

<http://www.theguardian.com/commentisfree/2013/oct/22/angel-kidnapped-by-gypsies-libel-replayed>

TREGIMI I HISTORIVE

Një element thelbësor i të gjitha pikave të mësipërme është nevoja për të treguar histori në një mënyrë të fuqishme, bindëse, dhe që të bën për vete. Në mënyrë që mediet dhe gazetarët të zbatojnë me efikasitet udhëzimet dhe kodin e sjelljes, tregimi i historive në mënyrë të shkëlqyer duhet të jetë në qendër të çdo reportazhi.

Ekzistojnë disa shembuj shumë të mirë si për tregimet e mira edhe ato të këqija në Kolegjin e Gazetarisë të BBC-së.

Raportimi në lidhje me fëmijët
<http://www.bbc.co.uk/academy/journalism/article/art20140428142034522>
dhe Pasqyrimi më i mirë i mundshëm i fëmijëve në reportazhet tuaja
<http://www.bbc.co.uk/academy/journalism/article/art20140522115128283>

INFORMACIONE SHITESË DHE LEXIM

Ky kod i sjelljes është hartuar me qëllim që t'i njoftojë mediet, gazetarët dhe cilëndo palë që përfshihet në portretizimin e fëmijëve, me udhëzuesin për raportim të përgjegjshëm. Më poshtë jepen mjaft informata dhe materiale për lexim të mëtejshëm. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës dhe udhëzuesit e Komisionit të Pavarur për Media të Kosovës ofrojnë hollësi të shkëlqyera në lidhje me mënyrën e trajtimit të fëmijëve në medie.

Në doracakun për verifikim gjenden këshilla nga më cilësoret për verifikimin dhe mbrojtjen në mediet sociale dhe digjitale, ndërkohë që në

faqen e internetit “BBC College of Journalism (Kolegji i BBC-së për Gazetarinë)” mund të gjeni informata të hollësishme lidhur me raportimin për fëmijët. Të gjitha materialet e renditura më poshtë do t'i ndihmojnë gazetarët dhe mediet që, në një mënyrë shumë më efektive dhe tërheqëse, të mbulojnë lajme të cilat lidhen me fëmijët dhe problematikat e tyre.

SHTOJCË

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
http://www.unicef.org.uk/Documents/Publication-pdfs/UNCRC_summary.pdf

Udhëzuesi i Komisionit të Pavarur për Media
<http://kpm-ks.org/?faqe=271&guha=3>

Udhëzimet editoriale të BBC-së
<http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/page/guidelines-children-introduction/>

Doracaku për verifikimin
<http://verificationhandbook.com/>

BBC College of Journalism (Kolegji i BBC-së për Gazetarinë)

Raportimi në lidhje me fëmijët
<http://www.bbc.co.uk/academy/journalism/article/art20140428142034522>

Pasqyrimi më i mirë i mundshëm i fëmijëve në reportazhet tuaja
<http://www.bbc.co.uk/academy/journalism/article/art20140522115128283>

Raportimi i rasteve të abuzimit
<http://www.bbc.co.uk/academy/journalism/article/art20140610145725989>